



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 14323 Prot

Vlorë, më 16.11 2023

PROJEKT – VENDIM  
Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_. 2023

**PËR  
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË  
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË  
DELEGUARA - 2024**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 64 pika c të Kreut X, VKM nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, Ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, VKB nr. 87, datë 23.12.2022 “Pë miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara – 2023“ i ndryshuar;

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë si vijon:

• Në administratën e Bashkisë Vlorë	318 punonjës
• Konvikti (Arsimi profesional)	16 punonjës
• Çerdhet	17 punonjës
• Sektori i Ndriçimit	15 punonjës
• Arsimi (Punonjës jomësitor/ mësues ndihmës dhe Inspektor QKF)	40 punonjës
• Në Qendrën e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	14 punonjës
• Në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike	396 punonjës
• Në Qendrën Kulturore	30 punonjës
• Në Teatrin Petro Marko	28 punonjës
• Në Klubin Shumësportësh “Flamurtari”	18 punonjës
• Në Qendrën e Zhvillimit PAK	22 punonjës
• Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen	11 punonjës
• Në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane	39 punonjës

2. Të miratojë numrin e punonjësve në strukturën e Bashkisë ardhur me grant të kushtëzuar:

- Zyra e Gjendjes Civile 16 punonjës

3. Funksione të transferuara në Bashkinë Vlorë pas Reformës Territoriale:

- Arsimi parashkollor / punonjësit jomësimor (sistemi 9 vjeçar) 355 punonjës
- Arsimi i mesëm punonjes jomesimor 51 punonjes
- Sektori Bordit të Kullimit (Shtesë në strukturën NSHP) 17 punonjës
- Sektori e Pyjeve dhe Kullotave 13 punonjës
- Sektori e Rrugëve rurale (Shtesë në strukturën NSHP) 5 punonjës
- Sektori i MNZSH 50 punonjës

4. Të miratojë klasën dhe shtesën për pozicion të pagës për punonjësit e Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë si më poshtë:

#### Administrata e Bashkisë Vlorë

Pozicioni	Klasa	Shtesa per pozicion
Kryetar		185,000
Zv/Kryetar		160,000
Këshilltar	IIIA/1	73,900
Drejtor Kabineti	IIB	91,000
Sekretar këshilli	IIB	91,000
Sekretar kryetari/Specialist	IVB	44,000
Adm Rajoni	IIIA/1	73,900
Administrator NJ.A		95,000
Drejtor i Përgjithshëm	IIA	112,500
Drejtor Drejtorie	IIB	91,000
K/Inspektor	IIIA	80,300
Përgjegjës	IIIA	80,300
Specialist	IIIB	63,000
Specialist	IVA	56,000
Inspektor	IIIB	66,000
Përgjegjës	IIIA/1	73,900
Specialist IT	IIIB	63,000 +7,500
ND		47,000
K/Inspektor P. Bashkiake		84,700
Inspektor P. Bashkiake		61,300
Punonjës P. Bashkiake		54,900

ZGJC		
------	--	--

Ndriçimi	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	IIIA/1	73,900
Elektracist		47,000
ND		47,000

Çerdhet	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	IIIA/1	63,000
Kujdestar	IVB	44,000
Kujdestar		47,000
ND/MB		47,000

Konvikti (Arsimi profesional)	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	IIIA/1	73,900
Ekonomist	IVA	56,000
Punonjës edukativ	IVA	56,000
ND/MB		47,000

Arsimi	Klasa	Shtesa për pozicion
Mësuese ndihmese/ Inspektor QKF		
ND		47,000

**Qendra e Sherbimeve me Baze Komunitare per Femijet me Aftesi te Kufizuara**

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	IIB	91,000
Psikolog	IVA	56,000
Punonjës Social	IVA	56,000
Edukatore	IVB	44,000
Logoped	IVA	56,000
Fizioterapist	IVA	56,000
Pastruese		47,000

## Bordi i Kullimit

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	IIIA/1	66,000
ND/MB		47,000
Specialist	IVA	56.000

## Rrugët Rurale

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
ND/MB		47.000

## Qendra e Kulturës

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	IIB	91,000
Përgjegjës	IIIA/1	66,000
Punonjës	IVA	56,000
Punonjës	IVB	44,000
ND/MB		47,000

## Teatri Petro Marko

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	IIB	91,000
Përgjegjës	IIIA/1	66,000
Punonjës	IVA	56,000
Punonjës	IVB	44,000
ND/MB		47,000

## Klubi Shumësportësh “Flamurtari“

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	IIB	91,000
Financier	IIIA/1	66,000
Specialist	IVA	56,000
Inspektor	IVB	44,000
ND/MB		47,000

## Qendra e Zhvillimit PAK

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Kujdestare/Edukatore	IVB	44,000
Infermier/Logoped	IVA	56,000
Kujdestare		47,000
ND		47,000

## Ndërmarrja Publike per Menaxhimin e Mbetjeve Urbane

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	IIB	91,000
Përgjegjës	IIIA/1	73,900
Specialist	IVA	56,000
Specialist	IIIB	63,000
MB		47,000
ND		47,000

## Pyjet dhe Kullotat

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	IIIA/1	70,000
Specialist	IVA	56,000
Teknik Pyjesh		47,000

## Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	IIIA/1	60,000
Psikolog	IVA	56,000
Punonjës Social	IVA	56,000
Kujdestare	IVB	44,000
Kujdestare alternative		47,000
Pastruese		47,000

## Ndërmarrja e Shërbimeve Publike


Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	IIB	91,000
Përgjegjës	IIIA/1	66,000
Specialist	IVA	56,000
Specialist	IVB	44,000
Mbikëqyrës		47,000
Magaznier		47,000
Shofer		47,000
ND/MB		47,000
Spektori i Gjellbërimit		47,000
Spektori i Pastrimit		47,000
Spektori i mirëmbajtjes së varrezave		47,000

5. a. Shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën 2% për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit.  
  
b. Punonjësit administrativë, përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.
6. Fondi i pagës për punonjësit e Bashkisë, Institucionet e varësisë dhe funksioneve të transferuara pasqyrohet në buxhetin e Bashkisë Vlorë 2024.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

Konceptoi: L.Brinja

K. Mali

D. Demiri



**KRYETAR**

**Ermal Dredha**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 14323 prot.

Vlorë, më 16.11 2023

**RELACION**  
**PËR PROJEKT-VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA – 2024”**

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b, të Kreut III, neni 54 pika ç dhe dh, Kreu IX, neni 64, pika a, b, c, ç dhe d të Kreut X, është kompetencë e Këshillit Bashkiak miratimi i numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë dhe i nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me projekt vendimin e paraqitur në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, ju informojmë se:

**Për pikën 1 dhe 2.** Miratimi i numrit të punonjësve të Bashkisë Vlorë.

1. Numri në total i punonjësve në Administratën e Bashkisë është 420, ndarë si më poshtë:

	<b>Ishte</b>	<b>Bëhet</b>
• Në administratën e Bashkisë Vlorë	283 punonjës	318 punonjës
• Konvikti (Arsimi profesional)	16 punonjës	16 punonjës
• Çerdhet	17 punonjës	17 punonjës
• Sektori i Ndriçimit	15 punonjës	15 punonjës
• Arsimi (Punonjës jomësitor/ mësues ndihmës dhe Inspektor QKF)	40 punonjës	40 punonjës
• Në Qendrën e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	14 punonjës	14 punonjës

2. Numri i punonjësve në Institucioneve të Varësisë, ndarë si më poshtë:

	<b>Ishte</b>	<b>Bëhet</b>
• Në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike	396 punonjës	396 punonjës
• Në Qendrën Kulturore	30 punonjës	30 punonjës
• Në Teatrin Petro Marko	28 punonjës	28 punonjës

• Në Klubin Shumësportësh “Flamurtari”	16 punonjës	18 punonjës
• Në Qendrën e Zhvillimit PAK	12 punonjës	22 punonjës
• Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen	11 punonjës	11 punonjës
• Në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane	39 punonjës	39 punonjës

Të miratojë numrin e punonjësve në strukturën e Bashkisë ardhur me grant të kushtëzuar:

- Zyra e Gjendjes Civile 16 punonjës

### **I. Administrata e Bashkisë Vlorë**

Ndryshimi i numrit të punonjësve në administratën e Bashkisë Vlorë vjen si pasojë e procesit të ristrukturimit të nisur nga Kryetari i Bashkisë. Ky proces i ristrukturimit do të japë përparësi riorganizimit të Policisë Bashkiake dhe rritjes së numrit të punonjësve të saj, në mbështetje edhe të Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”.

### **II. Në Klubin Shumësportësh “Flamurtari”**

**18 punonjës**

Referuar kërkesave dhe nevojave për mirëfunksionimin e Klubit Shumësportësh “Flamurtari”, ka një rritje me 2 punonjës për këtë Institucion të varësisë.

### **III. Në Qendrën e Zhvillimit PAK**

**22 punonjës**

Në rastin e Shtëpisë së Foshnjës:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është e angazhuar, të transformojë shërbimet rezidenciale për fëmijë në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror (IPSH-publike), në mënyrë që bashkitë të mund të përdorin buxhetin e institucionit për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit parandalues dhe alternative për fëmijët dhe familjen. Plani i transformimit të IPSH-ve propozon një model transformimi, i cili ruan buxhetin dhe burimet njerëzore, por mbulon në të njëjtën kohë boshllëkun ekzistues në sistemin e kujdesit alterantiv ndaj fëmijëve pa kujdes prindëror. Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen mund të zëvendësojnë institucionet ekzistuese, (me të njëjtin mekanizëm financimi) të cilat do të përfshijnë ekipe me punonjës socialë, psikologë dhe profesionistë të tjerë, për të ofruar mbështetje për fëmijët dhe familjet dhe një sistem alternativ të kujdesit në nivel rajonal, nën mbikëqyrjen e Drejtorive Rajonale të Shërbimeve Sociale dhe Drejtorive të Shërbimeve Sociale në Njësitë Vendore.

Të dy Institucionet e përkujdesit shoqëror për grup-moshën e fëmijëve 0-5 vjeç në Bashkitë Korçë dhe Vlorë, të cilat në bazë të VKM nr.706, dt. 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit (PKD), 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”, Objektivi 2 strategjik, janë 2 institucionet e para të vendosura në moratorium dhe në fazë pilotimi të transformimit të shërbimeve. Në përputhje me PKD, Bashkia Korçë dhe Vlorë me mbështetjen e fondit social, po pilotojnë ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen, sipas modelit me të njëjtin titull të miratur nga MSHMS, si pjesë e planit të transformimit të shërbimeve rezidenciale në IPSH. *(Marrë nga Plani i transformimit për e përkujdesit shoqëror në Shqipëri, Pilot Bashkia Vlorë dhe Korçë 2023)*

Për shkak të numrit të ulët të fëmijëve në IPSH-në Vlorë dhe kërkesës së Qendrës së Zhvillimit PAK për rritje të numrit të personelit, Bashkia Vlorë do të vendosi transferimin e punonjësve të Shtëpisë së Foshnjës në Qendrën e Zhvillimit PAK. Struktura e Shtëpisë së Foshnjës ka në total 29 punonjës, 10 prej të cilëve janë pjesë e strukturës së Bashkisë dhe 19 punonjës janë pjesë e Strukturës së Drejtorisë



së Shërbimit Social Shtetëror. Në vijimësi Shtëpia e Foshnjes do të operojë me 19 punonjës të ardhur prej strukturës së DSHSS.

**Për pikën 3.** Funksione të transferuara në Bashkinë Vlorë pas Reformës Territoriale dhe Grantit për Bashkinë Vlorë 2024.

• Arsimi parashkollor / punonjësit jomësimitor (sistemi 9 vjeçar)	355 punonjës
• Arsimi i mesëm punonjes jomesimor	51 punonjes
• Bordi i Kullimit (Shtesë në strukturën NSHP)	17 punonjës
• Pyjet dhe Kullotat	13 punonjës
• Rrugët rurale (Shtesë në strukturën NSHP)	5 punonjës
• MNZSH	50 punonjës

Këto funksione janë të transferuara në Bashkinë Vlorë si pasojë e Reformës Territoriale. Për vitin 2024 nuk ka ndryshim në numrin e punonjësve për asnjë nga funksionet e mësipërme. Fondi i pagave për çdo funksion përcaktohet në ligjin e buxhetit për vitin 2024.

**Për pikën 4.** Të miratojë klasën dhe shtesën për pozicion të pagës për punonjësit e Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë.

Përcaktimi i klasave dhe shtesës për pozicion është bazuar në VKM nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Për vitin 2024 nuk do të ketë rritje page dhe do të vazhdojë të zbatohen shtesat për pozicion miratuar me V.K.B. nr 80 datë 28.10.2022.

Në këto kushte, Bashkia Vlorë i drejtohet Këshillit Bashkiak me këtë Projekt-Vendim “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024”.

Ju faleminderit!

